

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti II i botimit, Tetor 2008 Nr. 18. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



MUSLIMANET SOT DUHET TA RIBEJNE KALIFATIN ISLAM

Nuk ka kaluar shumë kohë, kur në kryeqytetin e Indonezisë, Xhakarta, u zhvillua një manifestim madhështor në të cilin pjesëmarrësit kërkuar rikrijimin e kalifatit mysliman si domosdoshmëri për të ndihmuar botën islame, që të dalë nga gjendja në të cilën ajo ndodhet sot. Shqetësimi i atyre myslimanëve, që protestuan në stadiumin e Xhakar-tës, të cilët ishin 200 000 persona, nuk ishte vetëm problem i tyre, por sot është problem i të gjithë botës islame e cila po përjeton një krizë të rëndë që ka prekur ekonomine e tyre ,politikën, moralin dhe vetë fenë islame. Kjo krizë është aq e lexueshme sa, me pak informacion që mund të marrë njeriu, bindet se kriza ekziston dhe po thellohet pa ndërprerje. Dhe në thellimin e saj janë përcaktues faktorë të jashtëm dhe po kaq të rrezikshëm janë edhe faktorët e mrendshëm në vendet myslimane. Faktori i jashtëm është i vendosur në një opozitë të egër me fenë islame dhe myslimanët që në momentin, kur Muhamedi a.s. filloi t'i thërrasë njerëzit në rrugën e Allahut xh.sh. dhe e vazhdoi këtë opozitë me fenë islame pa ndërprerje, duke ardhë deri në ditët tona me një agresivitet të jashtëzakonshëm, i cili duket tek kryqëzatat moderne që masakrojnë qytetarë të pafajshëm ,rrënojnë shtete të tëra me zjarr e hekur, ku humbin jeten miliona njerëz. Arena të përgjakshme, ku vriten myslimanë, sot ka në të gjithë botën, ku vetëm krimet në Irak dhe Afganistan janë të mjaftueshme për të treguar ash-përsinë e diversionit judeo-kristian kundër botës islame në ditët e sotme. Por, faktori i jashtëm nuk mjaftohet sot vetëm me agresionin ushtarak kundër botës islame. Ai shoqërohet



edhe me një diversion ekonomik i cili, përmes shoqatave dhe organizmave të fuqishme ndërkombëtare financiare i ka kthyer vendet myslimane në atavizma të ekonomisë së vendeve kristiane, ku ndihmesë kanë pasë edhe nga politika e këtyre vendeve ,sepse politikanë dhe qeveritarë myslimanë janë të lidhur me fije tëpanumurta me shtete dhe qarqe antimuslimane të cilat i kanë shkolluar dhe tashti u kërkojnë hakun përmes shërbimesh që shkojnë kundër interesave të myslimanëve. Sidomos, faktori i jashtëm ka qenë dhe është i interesuar që të montojë në vendet myslimane qeveri diktatoriale që t'u ngushtojë hapësirat myslimanëve, ku për model mund të kujtojmë Egjiptin në të cilin është numuri më i madh i të burgosurve myslimanë se në çdo shtet të tjetër të botës. Por, më pak i rëndësishëm nuk është edhe faktori mrendshëm në thellimin e krizës së vendeve myslimane. Qeveritë vasale janë të

panumërta në vendet myslimane, të cilat, me politikat e tyre antikom-bëtare dhe antimuslimane, e kanë errësuar të ardhmen e botës islame. Por, ajo që të shqetëson shumë është fitneja dhe përçarja fetare që është e evidente në vendet myslimane sot. Ajo po manifestohet tek përplasjet në mes grupeve myslimane dhe vetë shteteve myslimane, duke krijuar një kaos të vërtetë që sjell armiqësi në mes të myslimanëve, kur uniteti është më i domosdoshëm se kurrë. Vetë gjakderdhja në mes të sunitëve dhe shittëve në Irak do të ishte e mjaftueshme për të bërë portretin e përçarjes që është sot në vendet myslimane. Prandaj, sot është më i rëndësishëm se asnjëherë tjetër ribërja e kalifatit islam për të ndihmuar që bota islame të dalë nga kriza politike, ekonomike, morale dhe fetare ku është është për fat të keq sot. Muslimanët e kanë pasë kalifatit e tyre, por ai u rrëzua me ndërhyrjen e agjenturave jude-kristiane,

ku u angazhuan haptas edhe shtete si, Anglia dhe Franca, që patën qenë flamurtare të kryqëzatave gjakatare në Lindje, ku masakrat e tyre kundër myslimanëve ishin jashtë parame-trave të qenieve njerëzore. Rrëzimi i kalifatit islam në Turqi solli lindjen e një laicizmi të rrezikshëm i cili do të bënte që Turqia e kalifatit islam në zhytej në një atmosferë të rrezikshme afetare.

Prandaj, sot bota islame ka nevojë për një shtet bërthamë që të marrë në dorë drejtimin e saj që vendet myslimane të kenë qendrën e vet si është Vatikani për katolikët dhe Patriarkana për ortodoksit. Por, shteti që duhet të marrë përsipër kalifati islam duhet të plotësojë parametrat politikë, ekonomikë, ushtarakë, traditën, pozicionin gjeografik dhe eksperiencën në realizimin e një misioni të tillë. Dhe analistët e quajnë të mundshme dhe favorite të vetme Turqinë, sepse është vetëm ky shtet që i pëmbush standardet për të marrë përsipër koordinimin e veprimeve të botës islame sot. Prandaj edhe demonstuan myslimanët në Xhakarta me qindra mijra që të zgjojnë nga gjumi myslimanët në të gjithë botën për të rindërtuar kalifatin islam si mundësi e rëndësishme që do të ndihmojë botën islame të njohë madhësitinë që i takon dhe kriza e saj të jetë një tregues që i përket të së kaluarës

Selim Gokaj


GËZUAR DHE PËRSHUMËVJET FITËR BAJRAMIN

Përse vendet arabe nuk e njohin pavarësinë e Kosovës

Në këtë gusht 2008 kur shoqëria civile kosovare organizoi konferencën "Kosova dhe Bota Arabe", politikanët kosovarë, përveç përfaqësimit shumë të ulët që bënë në këtë konferencë ku as që denjuan që t'i falenderojnë dhe t'ju kërkojnë arabëve njohje të shtetit të tyre; bënë gafa edhe më të mëdha me sjelljen feminare të kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi. që i quajti vendet arabe dhe myslimane si "adresa të dyshimta". Por arroganca e kosovarëve dhe shqiptarëve ndaj popujve arabë dhe islamikë duket tek Prifti katolik Ardian Ndreca psh. në Gazetën 55 të datës 8 shtator 2008 arabët i fyente me terma aq racistë dhe të turpshëm për një prift katolik.

"Kah na dolën "vëllezën" arabët? Cila shkencë na nxjerr ne vëllezën me ta? As gjuha, as raca, as etnia nuk na bashkojnë me ta... Rezultati i gjithë kësaj historie asht se nuk mund të ecim ma si pula pa krye tue kërkuje aleanca boshe, të cilat vetëm na damtojmë – siç na kanë damtue, pse ndihmë prej tyne s'na ka ardhë kurrë. Kemi nevojë për një frymë të re në politikë, për ndryshime ma rranjë."

Arroganca kosovare dhe shqiptare kundër botës arabe dhe islame është aq e dhimbshme saqë emisari amerikan pranë Organizatës së Konferencës Islamike, Sada Cumber ka vënë në pah që: "Që nga viti 1990, përveç ndonjë vizite në Turqi, liderët kosovarë nuk kanë qenë të interesuar të krijojnë kontakte me shtetet me popullata myslimane. Përfaqësuesit e institucioneve kosovare nuk kanë bërë asnjë vizitë zyrtare në shtetet myslimane në Azi dhe në Afrikë, përveç një pjesëmarrje në Konferencën e Shteteve Islamike që është mbajtur para disa muajsh në Senegal, ku ka qenë i pranishëm ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj." Këtë varësi dhe shkurtmendësi të leadershipit kosovarët e vë në pah edhe kryetari i Organizatës së Konferencës Islamike, Ekmeledin Ihsanoglu i cili në intervistën më të fundme dhënë BBC-së vë në pah pazotësinë politike kosovare dhe ju kujton atyre që nëse këta duan



që të njihen nga bota myslimane: "Ata duhet t'u thonë botës myslimane se janë myslimanë dhe jo vetëm të thonë se jemi kosovarë." Por edhe pse nga pala shqiptare dhe kosovare në këto vitet e fundit, politika amerikanofile e Tiranës dhe e Prishtinës i ka sjellë sa e sa dëme dhe ofendime popujve arabë dhe muslimanë, shkruesin e këtij shkrimin e habisin disa shkrues islamofobë në shtypin e Tiranës dhe të Prishtinës të cilët në këto muajt e fundit kanë nisur të kuptojnë rëndësinë e botës arabe dhe islame dhe pyesin muslimanët shqiptarë "pse vendet arabe nuk po e njohin Kosovën?" Kur lexoj pyetje dhe shkrime të këtilla nga disa gazetarë dhe politikanë në Tiranë, Prishtinë apo edhe Uashington mua më duhet t'i pyes politikanët kosovarë dhe shefat e tyre perëndimorë se çfarë keni bërë ju që bota arabe të njohë Kosovën të pavarur? Arabët nga Kosova dhe Shqipëria, përveç dhënies së ndihmave prej disa miliona dollarësh në këto vitet e fundit; si shpërblim kanë marrë vetëm ofendime, dëbime, vrasje dhe injorim. Gazetarët e Gazetës Shqiptare të Karlo Bolinos në Tiranë, që në një seri numrash pyesin se përse arabët nuk po e njohin Kosovën e pavarur, janë vetë dëshmitarë të atyre qindra shkrime-

ve fyese që ata kanë botuar kundër myslimanëve dhe arabëve në këto 15 vitet e fundit. Janë dëshmitarë të brohoritjeve që ata i kanë bërë vrasjeve, persekutimeve të arabëve. Më qindra arabë janë dëbuar pa asnjë justifikim nga Shqipëria dhe abuzuar me të gjitha mënyrat, ndërsa mediat, si kosovare ashtu edhe shqiptare kanë vërsuar pa mbarim me terma racistë kundër popujve arabë dhe muslimanë. Shembulli më i fundëm i këtij diskriminimi është ai i vetëm përpara disa javëve, kur Shqipëria dëboi pa asnjë arsye dhe në mënyrë ilegale nga vendi bamirësin sudanez Ibrahim el-Meki i cili, sëbashku me ambasadorin kuvajtian në Bullgari, Ahmet Buzaber ishin duke lobizuar qeveritë e Gjirit Persik; Omanin, Katarin etj që të njohin pavarësinë e Kosovës.

E vetmja gjë që i lidh arabët me shqiptarët është Islami. Ama mediat e Prishtinës dhe të Tiranës dhe mendimtarët e "mëdhenjë" shqipfolës që nga Kadareja e deri te Rugova thonë që ne nuk jemi myslimanë. Nëpër rrugët e Prishtinës dhe të Tiranës, arabët nuk shohin asnjë shenjë që atyre mund t'iu kujtoj islamin, por vetëm se posterat e Bill Klintonit, Bushit, Nënë Terezës, Papë Gjon Palit II dhe katedralet katolike dhe ortodokse që

ngrihen, ndërsa myslimanët falen nëpër rrugë sikur të jenë refugjatë nga Maroku Përndryshe në një vend ku sheshin kryesor të kryeqytetit të tij e zë Nënë Tereza dhe jo Shejh Albani apo Dervish Hatixheja, në një vend ku heroi kombëtar i tij është Skënderbeu, atleti i Krishtit dhe jo sulltan Murati – atleti i Islamit; arabët e kanë shumë të vështirë që të kuptojnë se cili është ndryshimi ndërmjet një Kosove nën kryqin ortodoks me memorialin e Gazimestanit, nga Kosova nën kryqin katolik me bustet e Nënë Terezës.

Nëse kosovarët nuk i tregojnë botës së Islamit se ata janë përnjëmend myslimanë dhe Kosovën e duan si shtet për veten e tyre dhe se emrat Hashim e Rexhep i kanë përnjëmend islam, ata duhet të tregojnë origjinën e tyre. Përndryshe nëse vazhdojnë që të hedhin vickla kundër arabëve dhe islamit, kosovarët do të duhet që të kënaqen me izolimin e tyre nga bota islame, afrikane dhe aziatike, dhe ndoshta do të kenë shanse që t'i kërkojnë njohje në të ardhmen vetëm Indisë së Terezës dhe jo më Arabisë së Shejh Nasirudin Albanit.

Olsi Jazexhi

EDHE UNË PËR NUSEN TONË...

Duke marrur shkas nga gjendja e rënduar e 'Xhamisë së Plumbit'...

Mbaj mend se kur isha i vogël, para 15-vitesh, gjyshja (*pastë rahmet*) më merrte përdore dhe sëbashku shkonim në një nga lagjet e vjetra të Shkodrës, aty gjendet një xhami madhështore, e bukur dhe e hijshme për nga arkitektura me të cilën është e ndërtuar. Shkonim në 'Xhaminë e Plumbit' për të falur namaz e për të dëgjuar Kur'an... Nga shtëpia ime deri në 'Xhaminë e Plumbit' ishte rrugë e gjatë, mirëpo çdo të mërkure unë bashkë me gjyshen shkonim atje dhe e përdornim si një piknik të përjavshëm në shtëpinë e Zotit të Madhëruar!...

Edhe pse isha i vogël, gjyshja më tregonte e më thoshte se kjo xhami u ndërtua në vitin 1773 dhe, është vepër e hirësisë së tij Mehmet Pashë Plaku.⁽¹⁾ E merr emrin 'Xhamia e Plumbit', ngase të gjitha kupolat e saj ishin të mbuluara me plumb.

Mënyra se si u ndërtuar kjo xhami është unike dhe e veçantë në vetë llojin e vet. Xhamia është e ndërtuar nga guri dhe "i gjithë guri është i latuar, i bërë thujse me masa të njëjta, çka krijon simetri ndërtimore. Ai sillej nga fshati Gur i Zi nga populli, i cili rreshtohet varg me kilometra të tëra, nga Guri i Zi e deri tek vendi ku po ndërhohej xhamia. Në ndërtimin e saj mori pjesë edhe Mehmet Pasha, nën kujdesin e të cilit skaliteshin gurët. Pothuajse çdo ditë ai zbriste nga kalaja për të ndjekë ritmikën e punimeve."⁽²⁾

Imami i parë i kësaj xhamie ishte Haxhi Ahmet Misria. Haxhi Ahmeti ishte me origjinë nga Egjipti dhe nga kontaktet që kishte me Mustafa Pashë Bushatliun, ai vjen në Shqipëri, në Shkodër, dhe merr detyrën e imamit në xhaminë e Plumbit.⁽³⁾

Më pas kanë shërbyer hoxhallarë të tjerë në xhami, të cilët kanë shërbyer në shërbesat fetare, por edhe janë kujdesur për mirëmbajtjen e xhamisë, etj.

'Xhamia e Plumbit', në kohën e hershme për të cilën po flasim, kishte një rëndësi të madhe dhe ishte një objekt me vlera të larta.

1. Duke iu referuar pllakës që është e ngulitur në pjesën ballore të xhamisë.

2. Smajl Bala, "Institucionet Islame dhe hoxhallarët e Shkodrës", Boton "Camaj-Pipa", Shkodër, 2005, fq. 128

3. Po aty, fq. 131



Ajo nuk ishte vetëm një objekt kultiv në të cilin bëhesh adhurimet, ajo kishte një dimension e kuptim më të gjerë shoqëror e kulturor; luan-te një rol të rëndësishëm në jetën e qytetarëve shkodranë...

Mirëpo me kalimin e viteve, me degradimin dhe fillimin e shthurjes së shoqërisë njerëzore; 'Xhamia e Plumbit' filloi të humbiste atë nusesë dhe madhësinë e saj! Ajo filloi të dëmtohej si ndërtesë dhe plumbi, i cili mbulonte kupolat e saj, rreth vitit 1900 filloi të vidhej... Më pas, në kohën e pushtimit austriak rreth viteve 1916-1917, organet ushtarake ia hoqën edhe shtresat e tjera të mbetura...

Që në këtë periudhë filloi prishja e kësaj xhamie! Një gjë e tillë pohohet edhe nga vetë konsulli austriak në Shkodër, Theodor Ippen, në librin e tij "Shqipëria e vjetër": "Sado që nuk është shumë më e vjetër se 100-vjeçare, ndodhet në një gjendje aq të shkretë, saqë nuk mund të përdoret më."⁽⁴⁾ Kësisoj, që nga ajo kohë ka filluar shkatërrimi i kësaj xhamie, duke vazhduar nga viti në vit dhe, në vitin 1938, minareja e xhamisë ishte gjysmë e rrënuar... Në revistën "Zani i naltë", Shtator 1938, pohohet një gjë e tillë: "Më ra rasti, ndër këto ditë, me vizitue 'Xhaminë e Plumbit' në Shkodër, e cila për fat të keq ndodhet në shkatërrim e sipër prej vërsuljeve që i bën Drini çdo vit, sa të thuash krejt xhamia brenda është mbushur me dhé; gjithashtu edhe minareja e kësaj xhamie, mbas pak kohe shifet se ka me u rrezue, mbasi i kanë disa gurë afër sharaftit e mbas tashit është frikë me hy në këtë

4. Theodor Ippen, "Shqipëria e vjetër", Boton "K&B seria albanologjike", Tiranë, 2002, fq. 133.

minare."⁽⁵⁾

Nuk kaloi shumë kohë dhe minareja u shemb..., në këtë mënyrë ra edhe një element tjetër i veçantë i xhamisë!

Periodha e komunizmit e të tilla si kjo, ndërprejnë funksionimin e xhamisë; e për të bërë diçka për të, as që bëhej fjalë. Vetëm se e falënderojmë xhaxhin për mëshirën e tij të madhe që nuk e rrënoi dhe, që 'Xhamia e Plumbit' nuk pësoi atë fat që patën xhamitë e tjera në Shqipëri...

Më 16.11.1990, kjo xhami i parapriu xhamive të tjera në të gjithë Shqipërinë për rihapjen e fesë në vendin tonë. Pikërisht në këtë xhami u bë tubimi i parë fetar pas 23 vitesh ndërprerje (1967-1990), nga zotëria e tij Hafiz Sabri Koçi (*pastë rahmet*).

Edhe pse kjo xhami çdoherë ishte koherente me ngjarjet, edhe pse është e lashtë dhe madhështore për nga historia e për nga arkitektura, ajo vazhdoi çdo ditë të degradohej, deri në ditët e sotme. Vazhdon sërish, nuk ndalet!...

Sot akoma nuk kemi një gjë konkrete për restaurimin e saj, akoma nuk e ka vënë kush ujin në zjarr për të. Akoma vazhdojmë të vuajmë nga paradoksizma e drejtuesve të institucioneve që janë përgjegjëse për restaurimin e saj. Tallen me nusen tonë, po e restaurojmë sot, por e restaurojmë nesër, kaq fonde dritare, pas dy vitesh riparojmë tjetrën!...

Myftinia e Shkodrës me këmbë-

5. Revista "Zani i Naltë", "Mbi xhaminë e Plumbit në Shkodër", Viti XIII, nr. 9, Shtator, 1938.

ngulje ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë ndihmë në institucionet përgjegjëse për restaurimin e kësaj xhamie, por më kot... Për çdo gjë tjetër ka fonde dhe ndihmë, për këtë xhami nuk ka asgjë... Jo se nuk e meriton, por...

Pretendohet se ka projekte për rehabilitimin e saj, "por këto projekte nuk dihet në do të fillojnë ndonjëherë dhe në do të zbatohen një ditë, sepse bashkëpunimi mes dikastereve në fjalë është i ngrirë. Zakon i hershëm i institucioneve tona."⁽⁶⁾

Për imoralitetin ka fonde sa të doni, vetëm paraqitni një projekt prestigjioz, dhe ja paratë! Për koncerte degjeneruese, për lojëra, për emisione të shpifura, për çdo gjë; ama për restaurim të kësaj xhamie jo, s'ka!... Është me të vërtetë e pakuptimtë që nuk u restaurua tamam kjo xhami që në 1900-ën..., por kjo është një sprovë për të gjithë ne, sa bëjmë për të, sa kontribuojmë për ndryshimin e gjendjes së saj. Sa e ngrisim zërin përballë fëlliqësirave që tallen me të!

'Xhamia e Plumbit' vazhdon të vuajë... Në muret e saj ka dalur bar, sikur në vetvete kërkon ta ruajë pranverën!... Ne vazhdojmë të jemi të hareshëm dhe të 'aminshëm' me të gjithë ata që abuzojnë dhe kërkojnë të tallen me ne, me të gjithë ata që kanë urrejtje për nusen tonë...

Shkodër, më 27. 07. 2008

Mirsad Sylja

6. Anila Dushi, Gazeta "Shekulli", <http://www.shekulli.com.al/news/53/ARTICLE/28952/2008-07-21.html>

Bota islame dhe Pavarësia e Kosovës

Opinionjoni publik shqiptar në dy anët e kufirit po shpreh shqetësimin e tij për qëndrimin që po mbajnë shumica e vendeve myslimane të cilat nuk po e njohin Pavarësinë e Kosovës, pavarësisht inkursioneve të pandërprera që ka ndërmarrë diplomacia shqiptare në këto vende, për të siguruar mbështetje tek këto vende që ata ta njohin Kosovën e Pavarur, inkursione që patën protagonistë figura të larta të politikës shqiptare si, Jozefina Topalli,

Lulzim Basha dhe vetë Sali Berisha. Por, duket se ky impenjim maksimal i këtyre misionarëve diplomatikë nuk ishte i mjaftueshëm, sepse vendet myslimane, që e kanë njohur deri tashti Pavarësinë e Kosovës janë të vogla në numur. Në një intervistë të ditëve të fundit, akademiku kosovar, Rexhep Qosja do të jepte mendime shumë interesante të cilat kanë mrenda tyre të vërteta të pakontestueshme që menduam t'i bënim publike edhe përmes gazetës Besimtari që të ndriçojmë, aq sa është mundësia, përse vendet myslimane vazhdoj-

në të mos e njohin në mënyrë masive Pavarësinë e Kosovës.

Për akademikun kosovar, në këtë qëndrim të këtyre vendeve ndaj Pavarësisë së Kosovës, rol negativ ka luajtur politika shpërfillëse e Shqiperise Londineze dhe e Kosovës kundra fese islame dhe rrëllimisht kundra myslimane, nën maskën e luftës globale kundër terrorizmit, në një kohë që myslimanët janë shumicë në këto hapësira. Rol negativ, për Rexhep Qosen, ka luajtur edhe racizmi kulturor dhe fetar kundërmusliman i Ismail Kadaresë që pat berë thirrje publike që shqiptarët duhet t'i kthehen fesë katolike si mundësi për t'u integruar në Evropën e Bashkuar. Pa tjetër rol negativ ka luajtur edhe ish-presidenti Rugova, që me politikën e tij, e konceptonte shtetin laik e modern të Kosovës me portretin e Papës në parlament. Të mos harrojmë se qendra studimore dhe politike të vendeve islamike i monitorojnë hapësirat myslimane në Ballkan dhe u mbushin dosje atyre që u bëhen opozitë myslimanëve dhe fesë islame aq

sa edhe vizitat diplomatike janë të pafuqishme për të fshirë gjynahet e tyre nga dosjet. Për akademikun kosovar, politika shqiptare po paguan një haraç jo të vogël për këtë qëndrim të saj ndaj vendeve myslimane dhe sidomos ndaj atyre arabe nga të cilat, sot kërkohet një mbështetje për të njohur Pavarësinë e Kosovës duke iu lutur në emër të asaj që vendet myslimane duhet të mbështesin Kosovën e Pavarur që ka një popullsi absolute myslimane. Në intervistën e tij, Rexhep Qosja na bën të ditur se tashmë, me urdhër të presidentit Fatmir Sejdiu është hequr nga parlamenti i Kosovës portreti i Papës, duke i kthyer këtij parlamenti karakterin laik që i takon një parlamenti në një shtet laik.

Akademik i shquar kosovar kujton edhe debatin e ashpër që ka bërë me Kadarenë ku bëri publik qëndrimin e një grupi të madh intelektualësh dhe politikanësh shqiptarë dhe kosovarë të cilët i bezdiste feja islame dhe myslimanët në ata parametra, sa ata nuk e durojnë as fenë islame as pasue-

sit e saj myslimanët, anipse ata janë shumicë e padiskutueshme në hapësirat ku jetojnë. Ne jemi të mendimit se në një të ardhme jo të largët vendet myslimane dhe ata arabe në veçanti do ta njohin Pavarësinë e Kosovës. Këtë hap ata do ta bëjnë, jo nga inkursionet diplomatike të politikës shqiptare drejt këtyre vendeve, por në emër të një uniteti real që duhet të egzistojë në mes të myslimanëve. Politika shqiptare duhet ta ketë të qartë se nuk mund të mbijetojë duke përdorë dy lugë gjatë ngrenjes, sepse rrezikohet që nesër mos të gjeje lugë për të ngrënë

dhe për pasojë do ta këtë të vështirë të mbijetojë. Ajo duhet të përpiqet që jetë e pavarur dhe jo e imponuar, sepse qerrja e huaj është thyer gjithmonë dhe ka zënë poshtë pasagjerët që kanë menduar se me këto lloj qerresh mund të bëjnë të sigurtë rrugë të gjata

Alban Kastrati

Martestat e përziara nuk i shpëtuan muslimanët e Bosnjës nga masakrat e miqve serbe

Profeti ynë i nderuar, Muhamedi a.s. na ka lënë në myslimanëve dhe gjithë njerëzimit porosi të çmuara të cilat e kalojnë cakun e porosive njerëzore, sepse ata janë edhe porosi profetike të udhëzuara nga Allahu xh.sh. të cilat, sidomos myslimanët, e kanë obligim parësor që t'i zatojnë në jetën e tyre. Porositë e Tij për familjen janë të një rëndësie të veçantë sot, kur morali dhe famija islame janë të kërcënuara më shumë se kurrë nga rreziku i shkatërrimit prej një morali të degjeneruar që u serviret myslimanëve në të gjithë botën si alternativë e zhvillimit njerëzor. Porosi të vyera na ka lënë Profeti ynë i nderuar, Muhamedi a.s. për të pasë kujdes në zgjedhjen e bashkëshortes, sepse bëhet fjalë për momentin, kur myslimani do të ndërtojë familjen e re të cilën Allahu xh.sh. do ta rrisë në numur, sipas dëshirës së tij. Profeti, Muhamedi a.s., i porositë mulimanët që bashkëshortja e tyre duhet të jetë fetare, sepse vetëm një fetare myslimane mund ta bëjë burrin të lumtur, mund të rrisë fëmijë me norma islame, mund të nderojë miqtë e burrit dhe mund të nderojë familjen e burrit.

Familjet myslimane, ku gruaja ka qenë një besimtare e devotshme, kanë qenë të suksesshme në jetëgjatësi dhe kanë jetuar në një harmoni që kanë qenë shembull edhe për familjet e tjera. Por, rastet nuk mungojnë, kur myslimanët dhe myslimane, për arsye e rrethanave nga më të ndryshme kanë realizuar martesat të për-

ziara me persona të një feje tjetër. Një rast që ia vlen të komentohet është Bosnja, e cila, para konfliktit të viteve 90, kishte në katër martesat, një martesë të përzier ku dhëndurët dhe nuset ishin serbë ortodoksë dhe kroatë katolikë. Në mediat e asaj kohe dhe deri në ditët e sotme, kjo dukuri është quajtur tolerancë e admirueshme në mes të religjioneve fetare, ku meritën ia jepnin myslimanëve si pjesë e strategjisë së qendrave antiislame, që punojnë për rrënimin e fesë islame, ku martesat e përziara shikohen nga ana e tyre si një mundësi për të krijuar "Një kalë Troje" mrenda një bashkësie muslimane. Martestat e përziara sollën në Bosnje dobësimin e imanit në familjen myslimane, sepse feja është pjesë e shpirtit të njeriut dhe si e tillë ajo e ka shumë të vështirë të tjetërsohet. Ata janë efektive vetëm, kur janë të shoqëruara me konvertimet e atyre dhëndurëve dhe nuseve që kanë pranuar të jenë pjesë e familjes myslimane. Por, është e njohur edhe e drejta që nusja, nga feja tjetër, të ruajë normat e fesë së saj dhe bashkëshorti mysliman t'i krijojë kushte, që ajo të mos heqë dorë nga religjioni i saj, deri sa ta quaj vetë të arsyeshme që të konvertohet në fenë e burrit mysliman. Por, martesat e përziara shumë herë janë shoqëruar me probleme dhe shqetësime mrenda këtyre familjeve duke bërë që këto lidhje martesash mos të merren si model për myslimanët, as në emër të një tolerance e cila faktikisht nuk funksionon. I pyetur në një intervistë për çështjen e martesave të përziara,

Kryetari i Bashkësisë Islame të Bosnjes, Mustafa Cerić do të deklarojë: "Unë nuk jam kundër martesave të përziara, por nuk i rekomandoj ata, sepse thujse të gjitha rastet që njoh unë kanë pasë probleme"

Dhe betejat që u bënë në Bosnje në vitet 90 treguan se martesat e përziara nuk funksionuan për të shpëtuar myslimanët nga masakrat e serbëve, megjithëse miqësitë dhe krushqitë me ata ishin të panumërta. Dëshmitarë të shumtë flasin se "miqtë" serbë e kroatë nuk i kursyen dhe nuk i mbrojtën "miqtë" e tyre myslimanë, por i vranë dhe i masakruan pa mëshirë. Në bilancin e dhimbshëm të luftës së Bosnjes numërohen mbi 200 mijë të vrarë, 200 mijë të plagosur, ku shumica e tyre janë civilë të përbërë nga gra dhe fëmijë. Është shumë e sigurtë se me mijra prej tyre ishin pjesë e familjeve me martesat të përziara të cilët e panë veten e tyre të zbuluar dhe të pambrojtur nga genocidi serb edhe kroat edhe pse u patën martuar dhe patën krijuar familje me serbë dhe kroatë. Prandaj, porositë e Kuranit të madhërishtë dhe hadithet e Muhamedit a.s. janë ata, ku myslimani duhet të mbështetet për të gjetur më optimalen, më të pranueshmen dhe më të sigurtën për të ndertuar familjen e tij dhe për ta ndertuar jetën e kësaj familjeje mrenda normave të moralit islam

Selim Gokaj

JA PSE NUK DO TE BEHEMI KATOLIKE!

Nga burimet historike, bile shumë nga to çuditërisht katolike, mësojmë se përgjatë shekujve katolicizmi kurrë nuk qe i fuqishëm midis shqiptarëve e veqanërisht në Kosovë...

Mitet e varura për qafe

Disa muaj më parë kur autoritetet më të larta të Kishës Katolike deklaruan se Kosova nuk do ta fitonte kurrë pavarësinë sikur të mos ishin 3 % katolikët e Kosovës unë, sikur edhe dy milion shqiptarë të tjerë përreth meje nuk patëm si të mos stepemi nga çudia e deklaratave të tilla dyftyrëshe, të pasakta, tendencioze dhe bile armiqësore; por në të njëjtën kohë ashtu krejt pa vetëdije nuk patëm si të mos i ikim përfundimisht kompleksit të fshehur të inferioritetit i cili i është skalitur me nge qe disa dekada shqiptarit musliman në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni, njësoj. Si në letrat e Eduard Saidit ishin 'ata' dhe më poshtë pastaj ne.

Shqiptari i rëndomtë edhe sot e në përjetësi është bërë të vuajë nga kompleksiteti i mësuar dhëlpërisht nëpërmjet kulturës, historisë, letërsisë dhe bile edhe muzikës se gjoja Islami na u imponua dhunshëm dhe si i tillë duhet flakur bashkë me gjithçka që qoftë prej së largu tingëllon si i lidhur me të në ndonjë mënyrë. Një numër i madh i shqiptarëve edhe pse thellë në ndërdije i kanë parasysht të gjitha kontributet të cilat personalitetet Islame ia dhënë këtij kombi, edhe pse e dinë thellë në vete se Islami, cilido që të ketë qenë ai, nuk i ka sjellur kurrë një të keqe, megjithëkëtë ata nuk duan të mendojnë se një numër i konsiderueshëm i elitës intelektuale, akademike dhe kulturore së kombit të vet i ka gënjyer tmerrshëm në dekadat e fundit rreth qenësisë së tyre fetare e kombëtare.

Nga burimet historike, bile shumë nga to çuditërisht katolike, mësojmë se përgjatë shekujve katolicizmi kurrë nuk qe i fuqishëm midis shqiptarëve e veqanërisht në Kosovë, duke pasur probleme thelbësore me një priftëri të pashkolluar dhe padëgjueshmëri qytetare për bëmat e tyre. Ardhja e Osmanëve këtu e gjeti Kosovën jo si një ishull të satisfaksionit katolik, ashtu siç tentohet të na imponohet sot, por të zhytur në një luftë të paparë të Kishës Bizantino-Ortodokse Serbe për shkombëtarizim të vazhdueshëm të shqiptarëve këtu. Këto fakte kurrë nuk iu bëhen të ditura nga paria e sotme katolike njerëzve të cilët trumbetojnë se po konvertohen në fenë e të parëve.

Ajo çka priftërinjtë katolikë nuk u tregojnë 'të konvertuarve' të supozuar në meshën e pagëzimit është se shqiptarët në Kosovë e pranuan Islamin në masën më të madhe si zgjedhje personale, si reagim ndaj dhunimit asimilues dhe poshtërujes të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe gjithashtu nuk kishte si të ishte ndryshe kur kihet parasysht dembelia ekstreme e klerit të pashkolluar katolik midis shqiptarëve. Këtë e pohojnë të gjithë historianët e paanshëm, të huaj dhe shqiptarë, dhe është fatkeqësi që të tillëve nuk u është dhënë hapësira e duhur në historiografinë zyrtare shqiptare.

Analet historike të kohës nuk janë as për së largu në linjë me veprat imagjinate të Kadaresë për përunjësinë katolike proshqiptare dhe vrazhdësinë Osmane antikombëtare. Pranimi i Islamit nga shqiptarët, sidomos nga ata në Kosovë, ishte një revoltë ndaj politikave asimiluese të cilat ishin në qendër të luftërave naëve midis sekteve kristiane në këtë nënqiell. Duke e pranuar Islamin shqiptarët shpëtuan nga asgjësimi i mëtejme i tyre duke dhe u bënë për herë të parë në historinë e trazuar për ta të Ballkanit një entitet i veçantë me karakteristika specifike të cilat e pamundësonin çfarëdo tentimi të fqinjëve gllabërues për ti shkruirë etnikisht dhe kulturisht. Çirret e sotme të klerit katolik për gjoja pranimin e Islamit për shkak të taksave dhe dhunës janë hiç më shumë se sa përpjekje e fundit për ta fshehur pafuqinë dhe pasivitetin e tyre gjatë periudhës Osmane. Burimet historike të kohës, të cilat për shembull i ka analizuar mirë historiani Skender Riza, dëshmojnë se shqiptarët të cilët e pranuan Islamin kishin shumë më tepër obligime ndaj Perandorisë se sa të krishterët të cilët detyroheshin me një takse që të shumtën ishte simbolike.

Konvertimet që nuk janë konvertime

Duke lexuar ditëve të fundit deklaratat pompoze për konvertim në fenë e rrënjëve mu kujtua i madhi George Bernard Show. Me një rast ai pati thenë: "Konvertimi i Palit nuk ishte konvertim fare; ishte në fakt Pali ai që e konvertoi religjionin që e kishte ngritur një njeri mbi mëkatit dhe vdekjen". Hallall! Edhe këta të ashtuquajtur të konvertuar nuk janë aspak të konvertuar në katolicizëm; ata janë thjeshtë shëndërrues të dëmshëm të fesë në ideologji urrej-tjenxite se dhe përçmuese. Njëri nga ta derdhi gjithë atë urrej-tje ndaj fesë së 97 % të bashkëkombasve të tij dhe nuk kishte si të mos mendosh se njerëz të tillë jo vetëm që nuk i bëjnë shërbim katolicizmit, mashtrohen

thellë ata që e mendojnë kështu, por me një bagazh të tillë smire dhe amullie morale do t'ia tundin thellë edhe ato pak themele sinqeriteti që mund ti ketë Kisha Katolike në Kosovë.

Nuk e di pse kleri katolik abuzon me fjalën 'konvertim' kur të gjithë nga 'të konvertuarit' e supozuar kanë pohuar se nuk kanë qenë asnjëherë muslimanë përveç emrit të cilin e kanë trashëguar. Dihet fare mirë se gjatë fundit të Perandorisë Osmane ekzistonte një numër i caktuar i shqiptarëve të Kosovës të cilët formalisht morën emra muslimanë duke dashur që t'i bashkohen shumicës së popullatës që në masë të madhe për arsye patriotike dhe të mëvetësimi e kishte flakur besimin kristian dhe e kishte pranuar Islamin. Duhet t'u jemi mirënjohës natë e ditë atyre paraardhësve tanë të mençur të cilët e kundërshtuan lojën satanike të Kishës dhe e ruajtën qenien e tyre shqiptare nëpërmjet Islamit. Pa ta sot do të ishim vartës besnik të historisë Serbe në Ballkan. Burimet e Vatikanit pohojnë se në gjysmën e dytë të shekullit XVII, në trekëndëshin Deçan-Pejë-Drenicë nuk kishte katolikë fare. Me fjalë të tjera, banorët e krishterë të këtyre trevave (shqiptarët, serbët dhe vllahët), i përkisnin krejtësisht fesë ortodokse, prandaj edhe abuzimi me kthim tek rrënjët është hiç më shumë se një klishe e athët. Thomas Arnold, historiani i mirënjohur që i ka studiuar rrethanat ndër të cilat shqiptarët e pranuan Islamin pohon se hoxhallarët në viset shqiptare ishin krejtësisht shqiptarë për kundër misionarëve ortodoksë që ishin kryekëput serbë dhe atyre katolikë të cilët mungonin në të shumtën e rasteve e edhe kur ishin përbëheshin nga të pashkolluar dhe të largët nga komunikimi me masën. Hoxhallarët shqiptarë bënë çmos që shqiptarët ortodoksë t'i muslimanizonin dhe përpiqeshin t'i muslimanizonin edhe shqiptarët katolikë gjithashtu, të cilët ishin të rrezikuar nga kisha ortodokse e nuk kishin kurrfarë ndihme nga bota katolike e Evropës.

Prandaj ja pse nuk do të bëhemi katolikë as unë, as familja ime, e as shumica e shqiptarëve; sepse jemi të tillë si jemi sot duke iu falënderuar pikërisht Islamit dhe jo mosdijes së priftërisë së atëhershme katolike.

Sepse e vërteta na ka bërë të lirë

Megjithë tërë këto të vërteta të cilat i mësova gjatë rrugës sime për ta qartësuar idenë e dëgjuar kudo përreth meje se Islami na u imponua dhunshëm dhe se Katolicizmi do të na shpëtonte nga të gjitha të këqijat e tij, prapëseprapë pak ditë

pasi që e mora në duar Biblën katolike në përgatitje të Don Simon Filipajt e pashë se arsyet teologjike për të mos u 'kthyer në rrënjët' katolike janë shumë më të mëdha se ato historike.

Është hipokrizi patetike se si klerikët katolikë e quajnë 'moment grandioz historik' dhe 'kthim tek e vërteta' të ashtuquajturin konvertim të disa individëve shqiptarë nëse supozojmë se ata e kanë lexuar ndonjëherë Biblën dhe komentimin e saj të cilin e kanë përgatitur vetë. Si mund t'i bindin priftërinjtë e tillë 'të konvertuarit' e rinj se Bibla është fjalë e Perëndisë kur komentimi i Biblës së botuar nga vetë ta në një mori rastesh pohon se një pjesë e madhe e shkrimeve të shenjta kristiane janë produkt i thashethemeve, legjendave dhe rrëfimeve antike. 'Të konvertuarit' bëjnë mirë ta lexojnë së pari Biblën para se të dëshmojnë se po e pranojnë katolicizmin. Të ngopurit e opinionit me rrëfime pseudopatriotike katolike i ka penguar këta të konvertuar të rinj që t'ia parashtrojnë vetvetes disa pyetje thelbësore të cilat jo vetëm që do të ju nevojiten për ta arritur paqen dhe qetësinë e shpirtit në këtë botë por edhe për ta mbërritur kënaqësinë e Zotit në Përjetësinë e andejme.

Nëse Islami paska ardhur me dhunë atëherë çfarë vlere më të mirë paska Katolicizmi papët e të cilit edhe dhunuan shkencëtarët, edhe vranë të pafajshmit edhe dogjën si shtriga njerëzit më eminentë të kulturës gjatë historisë. Priftërinjtë të cilët iu trumbetojnë të konvertuarve potencialë se po kthehen tek e vërteta nëse e pranojnë katolicizmin duhet t'ua bëjnë atyre të ditur se me pranimin e katolicizmit ata do të pranojnë të adhurojnë njeriun në vend të Hyut, do ta përuhin vetveten për falje mëkatesh para klerikëve në vend që ta ngrisin vetveten duke e bërë këtë vetëm me Zotin. Ja pse midis të tjerash, unë dhe shumica dërmuese e shqiptarëve, njerëzve të keqpërdorur nga klerikalizmi katolik, nuk do ta këmbëjmë me asgjë të vërtetën të cilën e kemi fituar me pranimin e Islamit. Të lirë kështu si jemi do t'u jemi përjetësisht mirënjohës paraardhësve tanë që me pranimin e fesë së re na shpëtuan nga asimilimi i fqinjëve gjakpirës dhe tash e tutje nuk do ta lejojmë as edhe priftërinë e sotme, qoftë ajo me emër edhe shqiptare, që të na udhëzojë rrugicave por do t'a tundojmë vetë Satanain për të rimbërritur tek e Vërteta dhe Zoti.

Halil IBRAHIMI

TOLSTOI - Si e braktisi Krishtërimin?

Kam dashuruar Krishtërimin më shumë sesa Kishën, tani më shumë dashuroj të vërtetën se të gjithë botën.

Tolstoi përbën një dukuri të jashtëzakonshme në letërsinë Evropiane dhe në atë botërore. Elementi i pazakontë ndodhet jo vetëm në veprat e tij, por edhe në pikëpamjen historiciste të mënyrës së të jetuarit dhe të menduarit të tij. Koordinatat kohore të shekullit XIX, periudhë në të cilën ai jetoi dhe krijoi, i kalojnë kufijtë deri në bashkëkohësi. Përthyerja e rrafshit kohor dhe hapësinor vjen për shumë arsye. Të parat janë arsye që lidhen me vetë jetën e shkrimtarit, sepse Tolstoi dhe pse jetoi në Rusinë krishtere, u bë ithtar i fesë islame duke befasuar mjedisin rrethues. Kjo nismë nuk mbeti në trajtën e një bindjeje vetjake, por solli revolucion shoqëror duke ndikuar në mendimin dhe edukimin fetar rus. Shembull i drejtpërdrejtë i këtij revolucion është botimi i broshurës së titulluar 'Muhammed', veper e publikuar gjatë periudhës së mbretërisë ruse në vitin 1909. Kjo veper nuk pati suksesin e vlerave reale që mbarte, për shkak se titulli konsiderohej heretik për shoqërinë ruse. Vetëm në 1990, pas një periudhe shtatëdhjetëvjeçare të Bashkimit Sovjetik, vepra e Tolstoit do të gjejë përsëri lexuesin dhe do të zgjohet interesi për vlerat fetare. Populli rus, veçanërisht intelektual

lët e vlerësonin Tolstoin për shkak të vlerave të tij në letërsi. Kjo nënkuptonte qartazi, se në qoftë se publikohej kalimi i tij në Islam, shoqëria ruse do të fillonte të kthehej fuqishëm në drejtim të Islamit. Për këtë shkak, librin e Tolstoit, ku janë tubuar disa hadithe të Muhamedit (a.s), organizatat ruse të shërbimit informativ, sikurse KKB-ja, janë orvatur që ta mbajnë në fshehtësi dhe në harresë, si dhe ta pengojnë ribotimin e mëtejshëm të tij. Ky libër e njohu lexuesin rus me disa hadithe të Muhamedit (a.s). Tematika e haditheve të mbledhura përqendrohet në sferën e 'varfërisë' dhe të 'barazisë', përmes të cilave orvatet të tregojë brengën e tij dhe të ndërgjegjësojë ata që janë të tradhtuar e të shtypur. Përmes këtij libri Tolstoi theksoi se Islami është vendi i drejtësisë dhe i barazisë së vërtetë, vëllazërisë dhe sakrificës, respektit dhe dashurisë ndaj njeriut dhe ndaj të tjerëve. Me krijimtarinë e tij letrare ai nxiti reagime të ndryshme në planin estetik, ideor dhe në atë moral, jo vetëm për bashkëkombësit e tij, por për mbarë botën. Tregues është shtrirja e veprave të tij si, 'Lufta dhe Paqja', 'Ana Karenina', 'Ringjallja', 'Polikushka', 'Haxhi Murati' etj, të cilat janë përkthyer në njëqind e tetë gjuhë të ndryshme të botës dhe janë botuar në më shumë se 220 milionë ekzemplarë. Kjo krijimtari është adoptuar për teatër,

televizion dhe radio. Këndvështrimi i Tolstoit ndaj Islamit mund të shihet edhe nga letrat e publikuara, veçanërisht vlen të përmendet letërkëmbimi me znj. Jelena Vekilova, e cila respekton dëshirën e fëmijëve të saj për t'u konvertuar në Islam. Gjithashtu, ai pati guximin që në ditarët dhe në letrat e tij të parashtrijë anën kontradiktore të shenjtërisë së Kishës. Në letrën e dërguar Sinodit të shenjtë, të cilin e kishte ekskomunikuar si të pa fe, ai deklaroi: 'E kam dashur Kishën më shumë se sa paqen time; pastaj më shumë kam dashuruar Krishtërimin se sa Kishën, ndërsa tani, më shumë dashuroj të vërtetën se të gjithë botën.'

Epiqendër e shqetësimit të Tolstoit është personaliteti moral i heronjve të tij, me të vërtetën dhe besimin, si kriteret më të larta të jetës. Raportin ndaj të vërtetës dhe fesë, autori e kërkoi dhe e sprovoi së pari në veten, e më pas me personazhet e veprave të tij, në të cilat çdo herë parashtron pyetje për moralin, drejtësinë, të vërtetën dhe fenë, për të mirën dhe të keqen, jetën dhe vdekjen, për çështjet e raporteve ndërmjet individëve dhe bashkësisë. Gjeniu letrar urrente të keqen, dhunën dhe shtypjen e popujve. Kalvarin e ndërkalimit të tij nga Krishtërimi në Islam, Tolstoi e përshkruan poetikisht, përmes simboleve të fuqishme religjioze. Gjithë atë që kam kaluar mund ta

shpjegoj në këtë mënyrë: Në një breg lumi më kishin vendosur në një barkë, e më pas barkën e drejtuan në drejtim të bregut tjetër, ndërsa në duar më dhanë lopatat dhe më lanë vetëm. Shihja se përreth meje lundronin mjaft barka, të cilat mbarteshin nga rrymat yjore. Lundrova aq larg, sa nuk munda të dëgjoj asgjë, përveç shushurimës së ujit të shpejtë. Pikërisht, në mes të ujit, në turmën e barkave dhe anijeve, unë plotësisht e kisha humbur drejtimin. U ktheva prapa, në drejtim të ujit dhe e orientova barkën nga brigjet e anës së kundërt. Bregu ishte Zoti, drejtimi ishte tradita, ndërsa lopatat për lundrim paraqisnin lirinë që m'u dha. Lopatat për lundrim më ndihmuan që të arrij deri në breg, që të afrohem tek Zoti. Intensiteti i madh i ideve dhe veprave të Tolstoit shpreh pikëpamjet dhe bindjen e plotë të tij për islamizmin, duke braktisur kështu një herë e përgjithmonë Krishtërimin, kur ai thotë: 'Nuk mund ta pranoj fenë e krishterë, sepse ky besim nuk ishte feja, por një mënyrë e kënaqësisë epikuriste të jetesës. E kam kuptuar se ajo fe nuk i ofron njeriut qetësi; ndoshta mund t'i shërbejë dikujt, i cili është penduar në shtratin e vdekjes.' Ky zjarr pendese nuk e zhuriti shpirtin e Tolstoit, sepse ai jetoi, krijoi dhe u varros sipas rregullave islame.

Jolanda LILA

SHBA: 115 ushtarë kryen vetëvrasje në 2007

Armata e Shteteve të Bashkuara tha se 115 ushtarë të saj aktivë kanë kryer vetëvrasje në vitin 2007 gje, që paraqet bilancin më tragjik që nga regjistrimi i këtyre incidenteve në vitin 1980. Më shumë se 25 për qind e vetëvrasjeve janë kryer gjatë shërbimit në Irak. Zyrtarët e ushtrisë thanë se dislokimi në Irak dhe në Afganistan është burimi kryesor i stresit të ushtarëve amerikane

Duket se slloganet politike, që keta trupa ushtarake jene paqeruajtese, nuk jane te mjaftueshme per te krijuar nje klime mirebesimi ne Irak dhe Afganistan, ku banoret e ketyre vendeve po shikojne se, ne emer te nje lufte qe emertohet be-teje kunder terrorizmit, po behen akte te renda kunder civileve nga

bombardimet qe po vrasin dhjetra dhe qindra civile dhe pasaj kerkohet falje me arsyetimin se aviatorët kane gabuar ne shinjestrat e tyre. Te mos harrojme se viktimat e luftimeve ne Irak kane kaluar nje milion njerez dhe pak jane ata qe kane dale para drejtesise per t'u ndeshkuar, ne nje kohe qe eshte pohuar se te dhenat e zbulimit nuk kane qene te sakta per rrezikun e armeve te shkaterrimit ne mase, qe gjoja I ka poseduar Iraku I Sadam Hysejnit qe ka mundesi qe te kete paguar per bombardimet me raketat qe I beri Izraelit ne luften e pare te Gjirit. Ketyre fakteve u duhet shtuar edhe protesta e qytetareve ne Sh.B.A dhe ne shume vende te botes kunder luftes ne Irak dhe Afganistan te cilat I akuzojne trupat ushtarake aleate dhe ata amerika-

ne per nje lufe te padrejte dhe per krime, ku zeniti I tyre ishte ne burgun Ebu Garib dhe vazhdon te jete ne Guantanamo. Gjithashtu, lufta qe bejne guerilasit ne keta vende eshte e ashper dhe e pameshireshme, duke shkaktuar mijra viktime ne mes te ushtrise amerikane dhe asaj te aleateve qe mbeshtesin amerikanet ne keta aventura te rrezikshme. As premtimet se do te kete terheqje te trupave nga Iraku ne nje afat kohor, qe leviz sikur te ishte flug ere, nuk jane te mjaftueshme per te besuar se lufta ne Irak do te ndalet. Kurse, per Afganistanin as qe flitet per pushim zjarri dhe largimin e trupave nga ajo hapësire, sepse duket qe atje beteja nuk do te kete fund kurre. Pa tjetër se keta tregues kane rol paresor ne strecimin e ushtareve

amerikane qe e gjejne rrugedaljen duke bere veprime deshperuese qe jane vetevrasjet, qe duket se do te vazhdojne te rriten, ne qofte se nuk jepet nje zgjidhje qe do t'i jepen fund ketyre akteve te renda njerezore. Dhe rrugesgjidhja e vetme optimale, per te ndaluar keto akte te renda njerezore, si jane vetvrasjet, eshte largimi I trupave amerikane dhe aleate, se bashku me ata shqiptare nga keto hapësira, ku si nje rast I rralle, vrasjet dhe vetvrasjet behen ne emer te paqes dhe trupat ushtarake, qe kryejne keto akte, quhen trupa paqeruajtese.

Vezhguesi

Përse muslimanët janë të prapambetur?!?

Një ndër pyetjet më të shpeshta në periudhën e dekadencës muslimane është: Përse jemi të dobët? Përse jemi të prapambetur? Përse bota muslimane është shërbetore e botës perëndimore? Përse shkalla e arsimimit në botën muslimane është e ulët? Kësodhe pyetje të ngjashme mund të rradhiten në pafund? A qëndron kjo pyetje? A qëndrojnë këto dilema?, apo janë pjellë e imagjinatës së të papunëve! Pa dyshim pyetja është e saktë dhe e qëndrueshme dhe është pozitive që muslimanët janë të vetëdijshëm për gjendjen e tyre. Në botën muslimane ka luftëra qytetare, në botën muslimane ka varfëri, në botën muslimane ka refugjatë, në botën muslimane ka arsimim të ulët, në botën muslimane çdo katastrofë natyrore (vërshim, termet apo diç e tillë) vretë mijëra e dhjetëra mijëra njerëz (kurse katastrofa të ngjashme në vendet perëndimore vretë 90-95% më pak njerëz.) Përse? Ku qëndron engima, misteri?! Edhe përgjigje janë ofruar nga muslimanët dhe nga jomuslimanët, por deri sot nuk kënaq asnjë prej tyre! Përse e themi këtë! Sikur ndonjë përgjigje të ishte me vend, bota muslimane do të kapërcente dobësinë, amullinë, konfuzionin ideor dhe praktik dhe do të bëhej fuqi kreative në botë. Gjendjen e muslimanëve në mënyrë meastrale e ka përshkruar një koleg boshnjak. Ai

thotë se muslimanëve nuk do t'i bëjë mirë vetëm një medikament, sepse bota muslimane i ngjan të sëmurit i cili ka arritur buzë vdekjes dhe nga dera e mjekut ky pacient nuk del me një diagnozë dhe me një medikament, por me shumë diagnoza dhe me shumë medikamente. (Ahmet Alibašić, Zašto smo slabi?, në: <http://www.alibasic.ba>. = boshti i shkrimit është nga ky burim). Përgjigje kanë ofruar shumë dijetarë, shumë politikanë, por ato disi nuk kanë gjetur mbështetje në jetën konkrete. Përgjigje ofroi edhe Ibn Halduni, edhe Ibn Tejmije, edhe Abdulvehabi, edhe Afganiu e Abduhuja, edhe Ikbali edhe Izetbegoviqi. Emra të mëdhenjë por të gjitha këto diagnoza disi janë joadekuate, të pjesëshme, të përkohshme, në dizarmoni me kohën dhe vendin që ofrohen. Sot bota muslimane është rreth një miliardë e gjysmë, mirëpo nuk paraqet faktor relevant për qendrat e vendosjes. Jemi mjaft në kuantitet, por kontributi ynë është i mangët, i pamjaftueshëm madje herëherë kontributi ynë është kundër nesh. Përse kështu? Edhe pse dijetarët kanë mendime të ndryshme, mendoj se kthimi në burimet islame dhe në përvojën pozitive historike, do të ofrojë përgjigje. Ta lexojmë Kur'anin së pari: "... E, nëse ju ia ktheni shpinën dhe i largoheni Atij, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, i cili nuk do ta ndjekë shem-

bullin tuaj." (Muhammed, 38). "... Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete. Kur Ai dëshiron ta ndëshkojë një popull, askush nuk mund ta pengojë Atë; dhe ata, përveç Tij, s'kanë asnjë ndihmës." (Er-Rra'd, 11) Ta lexojmë edhe një hadith të Muhammedit a.s.: "Do të vijë koha kur shumë popuj do të ju mësyjnë juve, sikurse populli i uritur që mësyn enën me ushqim. Dikush nga të pranishmit pyeti: A mos është kjo pse do të jemi pak? Jo, u përgjigj Pejgamberi a.s.. Përkundrazi, do të jeni shumë por do të jeni sikurse shkuma. Allahu nga krahërori i armiqëve tuaj do ta heq frikën që e kanë ndaj jush kurse në zemrat tuaja do të hedhë dobësi. Cila është kjo dobësi, o pejgamberi i Allahut, pyeti? Dashuria ndaj dynjasë (botës) dhe për-buzja ndaj vdekjes." (Ebu Davud, Sunen. Sipas: Hasen el-Benna, Mexhmu'atu resail (Kairo: Daru 'd-da've, 1990), 54). Të mendojmë pak. Numri i muslimanëve nuk është i vogël, por fuqia e tyre vërtet është sikurse shkuma e lëngut të gazuar të Coca-Colës apo Shvepsit. Edhe pse në fillim gota duket shumë e mbushur, për pak çaste e shohim gjysmë të zbrazët. A ndalohet sipas Islamit të dëshirohet bota? A ndalohet sipas Islamit të frikësohemi nga vdekja? Jo, edhe njëra edhe tjetra janë normale. Të dëshirohet bota dhe të mirat e saj është normale, madje imperativ islam. Por, edhe të kemi frikë nga vdekja është

normale, madje është provë që të bëhemi më të kujdesshëm sa jemi të fortë e në moshë të re. Por, nuk kemi të drejtë ta teprojmë në dashuria ndaj botës të kalojë në lakmi dhe frika ndaj vdekjes të kalojë në demoralizim. Ne vazhdimisht duhet ta ndjekim parimin islam: I lutemi Allahut të madhërishtëm për të mirat në këtë botë dhe të mirat në botën tjetër: "O Allahu ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër." Kur një as'hab bleu petka dhe iu lavdërua shokëve për petkat e reja, një nga shokët e tij e qortoi se kjo nuk i ka hije një besimtari. As'habi që kishite blerë petka shkoi te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti Muhammedin a.s. a mos ka gabuar, kurse Pejgamberi a.s. iu përgjigj se kjo nuk qëndron, sepse Allahu i don shenjat e bukurisë së begative të Tij në krijesat e Tij. (Imam Ahmed, Musned, nr. 7759). Po ashtu, kur Muhammedi a.s. e pa Amr ibn Asin me pasuri, briti me gëzim: "Pasuri e mirë te njeriu i mirë." (Imam Ahmed, Musned, nr. 17096). Edhe frika nga vdekja është njerëzore. Edhe Ademi a.s., edhe Musai a.s. kanë reaguar ndaj vdekjes. Edhe Muhammedi a.s. ka reaguar ndaj vdekjes së birit të tij, Ibrahimit, ndaj vdekjes së Hadixhes dhe Ebu Talibit. Por, frika nuk duhet të kalojë në lemeri, në tmerr, në humbje të vetëdijes dhe ekuilibrit.

Nexhat IBRAHIMI

Tregtojme MISH HALLALL
BESNIK ALUSHI ISMETI

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

Ju keni të drejtë të blini ku të doni por hallalli i vërtetë është vetëm tek market "ISMETI"

**Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692 101893**